



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KANCELARI

Nr.5242/1 prot.,

Tiranë, më 11.11.2024

Lënda: Njoftim për përfundimin e verifikimit paraprak të kandidatëve sipas procedurës “Lëvizje paralele”,

Në mbështetje të nenit 57 të ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 29 e në vijim, të kreut IV, të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, si dhe të udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor”, në përfundim të afatit kohor për dorëzimin e dokumentacionit të kandidatëve që konkurrojnë sipas procedurës “Lëvizje paralele” pranë Gjykatës së Lartë, për pozicionin vakant të shpallur me shpalljen e datës 24.10.2024 dhe pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të dorëzuar ju bëjmë me dije se :

- Për 1 (një) vend vakant , pozicioni “*specialist arkive*” , Drejtoria e Administrimit Gjyqësor, kategoria ekzekutive , IV-1 ,

kandidati i kualifikuar për fazën tjetër, atë të vlerësimit profesional nga Këshilli i Gjykatës është:

znj.Ermira Koci

Për **datën** dhe **orën** e intervistës së strukturuar me gojë nga Këshilli i Gjykatës së Lartë, për procedurën e konkurrimit “Lëvizje paralele” kandidati do të njoftohet nëpërmjet adresës elektronike të depozituar në dokumentacionin e dorëzuar.

Duke ju falenderuar,

KANCELAR NË DETYRË

ANILA KULO